



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 17 mars 2022
Nr. ref.:AGJ 1963/22

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI182/20

Parashtrues

Sedat Kovaçi, Servet Ergin, Ilirjana Kovaçi dhe Sabrije Zhubi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme
Rev. 54/2020 të 6 korrikut 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Sedat Kovaçi, Servet Ergin, Ilirjana Kovaçi dhe Sabrije Zhubi, të gjithë nga Prizreni (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës). Parashtruesit e kërkesës i përfaqëson avokati Esat Gutaj nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktvendimin e Gjykatës Supreme Rev. 54/2020 të 6 korrikut 2020, përmes të cilit është refuzuar kërkesa për revizion kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ac. nr. 2792/2014 të 18 shtatorit 2019.
3. Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme i është dorëzuar parashtruesve të kërkesës më 21 gusht 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se parashtruesve të kërkesës u janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 4 dhjetor 2020, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 30 dhjetor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha, Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërzhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban (anëtarë).
8. Më 12 janar 2021, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesve të kërkesës për regjistrim, dhe të njëjtën kohë kërkoi nga ata që të dorëzojnë në Gjykatë autorizimin për përfaqësimin e tyre.
9. Më 29 janar 2021, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës dërgoi autorizimin në Gjykatë.
10. Më 10 shkurt 2021, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
11. Gjithashtu, të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një njoftim Gjykatës Themelore për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që ajo të dorëzojë dëshminë e dorëzimit të aktvendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme.

12. Më 1 mars 2021, Gjykata Themelore dërgoi fletëkthesën si dëshmi se aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme i ishte dorëzuar përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës më 21 gusht 2020.
13. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullin 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Në bazë të paragrafit 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës u konfirmua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani do të merrte pozitën e Kryetares së Gjykatës pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale Arta Rama-Hajrizi, më 25 qershor 2021.
14. Më 26 qershor 2021, në bazë të paragrafit (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës Nr. KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa në bazë të pikës 1.1, paragrafi 1, i nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi e përfundoi mandatin e Kryetares dhe gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
15. Më 6 shtator 2021, Gjykata i dërgoi një shkresë shtesë përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës, përmes të cilës kërkoi që t'i sigurohen informata shtesë dhe vendime gjyqësore.
16. Të njëjtën ditë, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore që t'i sigurojë shkresat origjinale të lëndës.
17. Përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës nuk iu përgjigj shkresës së mëvonshme të Gjykatës brenda afatit të paraparë, prandaj, më 26 tetor 2021, Gjykata i dërgoi të njëjtën shkresë përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës.
18. Gjykata Themelore nuk i është përgjigjur kërkesës së Gjykatës që t'i dorëzohen të gjitha shkresat origjinale të lëndës, prandaj më 26 tetor 2021, Gjykata i dërgoi një kërkesë të re Gjykatës Themelore duke kërkuar që Gjykata Themelore të dorëzojë shkresat origjinale të lëndës.
19. Më 2 nëntor 2021, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës iu përgjigj kërkesës së Gjykatës dhe dërgoi informatat e kërkuara dhe vendimet gjyqësore.
20. Më 17 dhjetor 2021, Gjykata Themelore i dorëzoi Gjykatës shkresat origjinale të lëndës.
21. Më 20 janar 2022, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

22. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kanë iniciuar procedurë kontestimore në Gjykatën Themelore në Prizren kundër Komunës së Prizrenit, dhe për këtë qëllim kanë autorizuar avokatin S.R. nga Prizreni me kompetenca individuale që *“të përfaqësojë para Gjykatës në*

- procedurë civile dhe të ndërmarrë veprimet e mëposhtme procedurale dhe juridike, të marrë vendime gjyqësore, të bëjë ankim kundër vendimeve gjyqësore nëse është e nevojshme dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme juridike në këtë çështje kontestuese deri në përfundimin e saj me vendim të formës së prerë, si dhe t'ia kalojë këto kompetenca një avokati tjetër”.*
23. Me kërkesëpadi, parashtruesit kërkuar të vërtetohet se ata janë „bashkë-pronarë të patundshmërisë së evidentuar si ngastër kadastrale nr. 350 në sipërfaqe prej 0.69,40 ha, sipas fletës poseduese me nr. 90 ZK Petrovë, në madhësi dhe kufij: nga ana veriore me gjatësi prej 83,36 m , nga ana jugore me gjatësi prej 70.03 m, nga ana lindore me gjatësi prej 137,93 m, nga ana perëndimore me gjatësi prej 116,88 m, dhe se e paditura komuna e Prizrenit të obligohet që paditësve të ju njohë të drejtën e bashkëpronësisë dhe njëherë t'ua dorëzoj në shfrytëzim dhe posedim”. Ata e bazuan kërkesëpadinë e tyre në faktin “Paraardhësi i paditësve, tani i ndjeri S.I.K, sipas vendimit të Këshillit të vendit në Prizren me nr 9606 të datës 17.05.1946 i cili është fuqizuar me vendimin e Gjykatës së Rrethit për Kosovë me nr. 1817 të datës 25.05.1946, është shpallur si subjekt agrar me patundshmëri”.
 24. Më 14 maj 2008, Gjykata Komunale në Prizren nxori Aktgjykimin C. nr. 580/2003, përmes të cilit në pikën I, të dispozitivit, aprovoi kërkesëpadinë e paditësve dhe konstatoi se paditësit janë pronarë të ngastrës kadastrale nr. 350 me sipërfaqe prej 0.69.40 ha, sipas fletës poseduese nr. 90 z.k. fshati Petrovë, dhe e paditura është obliguar ta pranojë këtë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit. Në pikën II të dispozitivit, e paditura është detyruar t'ua dorëzojë paditësve posedimin e ngastrës kadastrale, dhe t'u lejojë atyre që në emër të kësaj ngastre në këtë zonë ta regjistrojnë në Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Kadastrës në Prizren, në emër të paditësve si bashkëpronarë të së njëjtës, për secilin prej tyre nga 1/5 (një e pesta) e pjesës ideale.
 25. Në arsyetimin e aktgjykimit, Gjykata Komunale konkludoi, “se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar, nga fakti se paluajtshmëria lëndore pa bazë juridike është regjistruar në emër të KP të Komunës së Prizrenit gjatë matjes detale të vitit 1957, dhe për shkak të afatit të shkurtër kohor gjer në vitin 1958, kur ka hyre në fuqi matja, paraardhësi i paditësve nuk ka mundur ta regjistrojë të njëjtën në emrin e tij, ngase nuk ka ditur se duhet, andaj ajo gjykatë ka vlerësuar se paditësit në bazë të trashëgimisë pas vdekjes se bashkëshortit - babait janë pronarë të patundshmërisë kontestuese, pastaj ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi”.
 26. E paditura parashtrroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren kundër Aktgjykimit C. nr. 580/2003 të Gjykatës Komunale në Prizren, të 14 majit 2008, duke pretenduar vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimin e së drejtës materiale.
 27. Më 18 shkurt 2009, Gjykata e Qarkut nxori Aktgjykimin Ac. nr. 541/2008, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Komunale në tërësi.

28. Pala e paditur ka parashtruar kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet të shkallëve më të ulëta të ndryshohen, në mënyrë që kërkesëpadia të refuzohet si e pabazuar ose të njëjtat të anulohen dhe rasti të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.
29. Më 4 qershor 2012, Gjykata Supreme nxori Aktvendimin Rev. nr. 309/2009, përmes të cilit aprovoi revizionin e të paditurës dhe ka anuluar Aktgjykimin Ac. nr. 541/2008 të 18 shkurtit 2009 të Gjykatës së Qarkut në Prizren, si dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore C. nr. 580/2003 të 14 majit 2008, dhe e ktheu çështjen për rigjykim.
30. Në arsyetimin e aktvendimit, Gjykata Supreme theksoi,

“Shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore ekzistojnë në faktin se dispozitivi i aktgjykimit i gjykatës së shkallës së parë është kontradiktor me arsyet e aktgjykimit. Kjo nga fakti se në dispozitivin e aktgjykimit fare nuk ceket nga cila bazë është vërtetuar se paditësit janë pronarë të parcelës kadastrale nr. 350 në sipërfaqe prej 0.69.40 ha, ndërsa në arsyetimin e aktgjykimit është cekur se: “Nga e gjithë kjo rrjedh se paditësit janë pronarë të parcelës kadastrale nr. 350 në sipërfaqe të tërësishme të cekur, sipas listës poseduese nr. 90 z.k. Petrovo selo, në bazë të trashëgimisë pas vdekjes së bashkëshortit dhe babait të tyre...”.

Në aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ngase, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk është vërtetuar historiat i parcelës kontestuese, ndërsa konstatimi në arsyetimin e aktgjykimit se në mënyrë të gabuar dhe pa bazë ligjore parcela kontestuese evidentohet në emrin e të paditurës, është i paqartë. Aktgjykimi duhet të bazohet në provat konkrete dhe konstatimet e gjykatës duhet të kenë mbështetje ligjore”.

31. Sipas përfundimit, Gjykata Supreme urdhëroi që “Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në rigjykim t'i mënjanojë të metat e sipërpërmendura, të vërtetoj bazën juridike të fitimit të pronësisë. Nga vendimi i ish Gjykatës së Rrethit për Kosmet del se paditësi është caktuar për subjekt agrar në sipërfaqe prej 0.50,00 ha, në vendin e quajtur „Jaglenica“, ndërsa gjykata ka vërtetuar se paditësi është pronar i parcelës kadastrale nr. 350 në sipërfaqe prej 0.69,40 ha, sipas listës poseduese nr. 90 z.k. Petrovë, ndërsa gjykata e shkallës së parë nuk ka nxjerrë prova relevante për të vërtetuar se ke mi të bëjmë me parcelën për të cilën paraardhësi i paditësit është shpallur subjekt agrar, dhe e njëjta paraqet bazë për fitimin e pronësisë së paraardhësit të paditësve, e me këtë bazë për trashëgimi të paditësve. Të vërtetohet nëse paraardhësi i paditësve nga viti 1957 (matjet detale) e deri më 19.2.2003 (data kur ka vdekur), a ka parashtruar kërkesë në procedurën administrative për kthimin e pronës kontestuese, dhe nëse po, nga cila bazë”.

Procedura e përsëritur gjyqësore në pajtim me Aktvendimin Rev. nr. 309/2009 të Gjykatës Supreme

32. Në procedurën e përsëritur, Gjykata Themelore mbajti seancat shqyrtuese, gjatë të cilave parashtruesit e kërkesës dhe pala e paditur paraqitën pikëpamjet e tyre mbi kërkesëpadinë. Parashtruesit e kërkesës deklaruan *“Paraardhësi i paditësve, tani i ndjeri S. I.K ish nga Prizreni sipas vendimit të Këshillit të Rrethit në Prizren me nr, 9606 të datës 17.05.1946 i cili është fuqizuar me vendimin e Gjykatës së Rrethit për Kosovë me nr. 1817 të datës 25.05.1946, është shpallur si subjekt agrar me patundshmëri”*. E paditura ka mohuar pretendimet e parashtruesve të kërkesës duke deklaruar *“[...] pra kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar, ngase i njëjti nuk ka qenë pronar i saj dhe se paditësit nuk kanë bazë ligjore për arsyetimin e kësaj kërkesëpadie ...”*
33. Më 10 prill 2014, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin C. nr. 681/12, me të cilin e refuzoi në tërësi kërkesën e parashtrueseve me arsyetimin:

„Gjykata në rastin konkret konstaton për faktin se me vendimin e Gjykatës së Rrethit për Kosovë me nr. 1817 të dt.25.05.1946 paraardhësi i paditësve Sylejman Kovaqi është shpallur si subjekt agrar pra nuk mund të nënkuptohet se i njëjti është shpallur pronar i patundshmërisë me shënime të dhëna në këtë aktvendim. Pra në rastin konkret meqë nuk është argumentuar se paraardhësi i paditësve ka fituar pronësinë në këtë patundshmëri shtrohet pyetja si mund tani trashëgimtarët e tij - paditësit në këtë çështje të kërkojnë bashkëpronësi në bazë të trashëgimisë, pronësinë të cilën paraardhësi i tyre nuk e ka pasur.

Në bazë të dispozitave ligjore ato të parapara me nenin 33 të LMTHJP-e drejta e pronësinë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në librat publik pra në rastin e fitimit të së drejtës së pronësisë përpos bazën juridike - justus titullus kërkohet dhe Modus aquirendi dhe se në rastin konkret palët paditëse nuk kanë argumentuar me asnjë provë se paraardhësi i tyre i ndjeri Sylejman Kovaqi e ka pas të regjistruar në librat kadastrale këtë patundshmëri, apo që të njëjtit më vonë - këta trashëgimtarët e kanë regjistruar në librat kadastrale këtë patundshmëri, pra paditësit nuk i kanë argumentuar këto fakte të rëndësishme për të vendosur lidhur me këtë kërkesëpadie të paditësve dhe se vetëm thirrja e paditësve se paraardhësi i tyre tani i ndjeri Sylejman Ibish Kovaqi është shpallur person agrar, për gjykatën nuk mund të jetë bazë ligjore se i njëjti e ka fituar dhe pronësinë në këtë patundshmëri kontestuese”.

34. Përfaqësuesi i autorizuar i parashtruesve të kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimin të Gjykatës Themelore, duke pretenduar, a) shkelje të nenit 181.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK), b) vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe c) zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.
35. Më 18 tetor 2019, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin Ac. nr. 2792/14, me të cilin e refuzoi si të pabazuar ankesën e përfaqësuesve të parashtruesve të kërkesës, ndërsa vërtetoi në tërësi Aktgjykimin C. nr. 681/12 të Gjykatës Themelore në Prizren të 10.04.2014.

36. Në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit thuhet:

“[...] gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka konstatuar gjendjen faktike. Ajo nga shkresat e lëndës ka konstatuar se paditësit nuk janë pronarë i ngastrës kadastrale kontestuese e në rastin konkret nga skica detale shihet se parcela kadastrale nr. 349 është në emër të tre pronarëve, duke u ndarë në parcela nr. 349/1 e regjistruar në emër të Neshat Dorambarit, parcela kadastrale nr. 349/1 e shënuar në emër të Qerim Gjinovcit dhe parcela kadastrale nr. 350 në sipërfaqe prej 4 ari dhe sipërfaqe prej 65.40 ari - livadh e regjistruar në emër të Këshillit Popullor të Komunës së Prizrenit.

Po ashtu ndërgjyqësit nuk kanë ofruar ndonjë provë para gjykatës së shkallës së parë për të vërtetuar se paraardhësi juridik i tyre e ka fituar pronësinë në baza ligjore, si dhe po ashtu në bazë të dispozitave të nenit 33 të LMTHJP e drejta e pronësisë fitohet me regjistrimin në librat publik e në rastin konkret paditësit nuk kanë arritur që ta argumentojnë me asnjë provë se paraardhësi juridik i tyre e ka pasur të regjistruar në regjistrat kadastral paluajtshmërinë kontestuese.

Gjykata e shkallës së parë mbi bazë të gjendjes faktike të konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë ka zbatuar të drejtën materiale, sepse në rastin konkret duhet të zbatohen dispozitat e nenit 20 të LMTHJP me të cilën kërkohet të vërtetohet baza juridike e fitimit të pronësisë dhe se në rastin konkret paditësit nuk e kanë argumentuar se paraardhësi juridik i tyre e ka fituar pronësinë në baza ligjore, si dhe po ashtu në bazë të dispozitave të nenit 33 të LMTHJP e drejta e pronësisë fitohet me regjistrimin në librat publik e në rastin konkret paditësit nuk kanë arritur që ta argumentojnë me asnjë provë se paraardhësi juridik i tyre e ka pasur të regjistruar në regjistrat kadastral paluajtshmërinë kontestuese.

37. Më 2 dhjetor 2019, avokati që përfaqësonte parashtruesit në pjesën e deritanishme të procedurës gjyqësore S.R., në pajtim me autorizimet që kishte të cilat parashikonin mundësinë e “bartjes së autorizimit tek një avokat tjetër”, ia transferoi autorizimin për përfaqësim të parashtruesve të kërkesës tek avokati Esat Gutaj (në tekstin e mëtejme: E.G.) nga Prizreni.
38. Më 9 dhjetor 2019, në emër të parashtruesit të kërkesës, revizioni në Gjykatën Supreme u dorëzua nga avokati i ri i parashtruesve të kërkesës E.G., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që revizioni të aprovohet si i bazuar dhe aktgjykimet e të dyja gjykatave të ndryshohen dhe të aprovohet si e bazuar në tërësi kërkesëpadia e parashtruesve të kërkesës.
39. Më 6 korrik 2020, Gjykata Supreme nxori Aktvendimin Rev. nr. 54/2020, përmes të cilit refuzoi si të pabazuar revizionin e avokatit E.G., nga Prizreni, të parashtruar në emër të parashtruesve të kërkesës, duke deklaruar se:

„në bazë të autorizimeve që gjenden në shkresat e lëndës, të gjithë paditësit e kanë autorizuar avokatin Sh. R. nga Prizreni, për të përfaqësuar

paditësit në këtë kontest. Nga shkresat e lëndës nuk rezulton se paditëset të kenë revokuar autorizimin e avokatit Sh. R.. Revizionin kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë në emër të paditësve e ka paraqitur E.G. avokat nga Prizreni, ndërsa në shkresat e lëndës nuk ka autorizim me të cilin vërtetohet se paditësit e kanë autorizuar avokatin në fjalë për ta paraqitur revizionin në emër të tyre.

Sipas nenit 89 të LPK-së, pala mund të autorizojë përfaqësuesin e saj që të kryejë vetëm disa veprime të caktuara apo të gjitha veprimet në një procedurë, ndërsa neni 90.1 i të njëjtit Ligj, parasheh se vëllimin e autorizimeve të përfaqësuesit me prokurë e cakton vetë pala, e cila autorizimin për përfaqësim e jep në formë të shkruar ose gojarisht në procesverbal tek gjykata.

E. G, avokat nga Prizreni, në procedurën sipas revizionit identifikohet si përfaqësues i paditësve. Përfaqësuesi me prokurë duhet të ketë autorizimin e dhënë nga pala dhe të identifikohet në autorizim emri i palës, të cilën e përfaqëson, pëlqimi i saj, dhe vëllimi i prokurës ose të gjitha këto pala autorizim dhënëse duhet ti konfirmoj gojarisht në procesverbal në gjykatë. Në shkresat e lëndës nuk ka autorizim me të cilin vërtetohet se paditësit e kanë autorizuar avokatin në fjalë për ta paraqitur revizionin në emër të tyre.

Me dispozitën e nenit 218.2. pika a) të LPK-së, parashihet që: „revizioni është i palejueshëm nëse e ka paraqitur personi i cili nuk është i autorizuar për paraqitjen e revizionit”. Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar E. G, avokat nga Prizreni, nuk ka pas autorizim nga paditësi për të përfaqësuar në këtë çështje juridike e për rrjedhojë as të parashtrij revizion kundër aktgjykimit të Gjykatës së shkallës së dytë. Prandaj, revizioni në këtë çështje, në kuptim të dispozitës së nenit 218.2 pika a) të LPK-së, hedhet si i palejuar”.

40. Më 8 shtator 2020, avokati E.G. dorëzoi në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit propozim për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, C. nr. 681/12, të 10 prillit 2014, Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ac. nr. 2792/14 të 18 tetorit 2019 dhe kundër Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 54/2020 të 6 korrikut 2020 “për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale në procedurën e vërtetimit të së drejtës së bashkëpronësisë mbi ngastrën në fjalë”.

41. Më 8 tetor 2020, Prokuroria e Shtetit i dërgoi njoftimin KMCL. nr. 126/2020 përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës, në të cilin thuhet,

“Duke pasur parasysh dispozitën e nenit 245 par. 245.1 dhe par. 245.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, në të cilën parashikohet që prokurori i shtetit mund të ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë brenda tre muajsh prej datës së pranimi të vendimit gjyqësor të formës së prerë si dhe vendimit të marrë në shkallë të dytë, dhe kundër vendimit të marrë në shkallë të parë, kundër të cilit nuk është bërë ankim prej ditës kur ky vendim nuk ka mundur më të kundërshtohet me ankim, por, si rregullohet nga paragrafi- 245.2 i nenit të përmendur të Ligjit për Procedurën

Kontestimore, prokurori i shtetit mund të ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë vetëm brenda tridhjetë ditëve nga data kur i është dërguar revizioni i asaj pale, prandaj, duke pasur parasysh dispozitat e mësipërme të ligjit si dhe një fakt të padiskutueshëm që i autorizuari i paditësve ishte avokat Shaip Ramadani, i cili ka pranuar aktgjykimin të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë Ac. Nr. 2792/14 i datës 18.10.2019 me 18.11.2019, gjë që vërtetohet, nga fletëdërgesa për dorëzim personal, i cili iu ka transferuar me 02.12.2019, gjë që vërtetohet nga një kopje të autorizimit të përmendur, ndërsa ju keni paraqitur propozimin për iniciim të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit më 17.09.2020, përkatësisht, pas skadimit të afatit ligjor prej tre muajsh, pra në kontekstin e më sipërm si dhe dispozitat e nenit në fjale të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me këtë informojmë, se keni humbur afatin ligjor për dorëzimin e propozimit për iniciim të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, sepse e keni dorëzuar propozimin pas skadimit të afatit ligjor prej tre muajsh.

Sa i përket vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 54/2020 i datës 06.07.2020, përkatësisht propozimit tuaj për ngritje të kërkesës për mbrojtjen të ligjshmërisë në vendimin e përmendur të Gjykatës Supreme të Kosovës sipas revizionit të deklaruar, propozimi juaj është i pabazuar, sepse neni 245 i Ligjit për Procedurën Kontestimore shprehimisht thotë kundër cilave vendime të gjykatës mund të paraqitet një propozim për iniciim të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë. Gjegjësisht, neni 245, par. 245.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore parasheh se propozimi për iniciim të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk lejohet sepse sikur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë ashtu edhe me rastin e revizionit gjykata kompetente është Gjykata Supreme, dhe nga kjo del se, propozimi juaj për iniciim të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimit të marrë për revizion nga Gjykata Supreme e Kosovës, është i pabazuar.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

42. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se përmes aktvendimit të Gjykatës Supreme janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave].
43. Megjithatë, parashtruesit e kërkesës në plan të parë të shkeljeve të pretenduara të neneve të Kushtetutës theksojnë faktin se Gjykata Supreme refuzoi kërkesën për revizion të parashtruar nga avokati E.G., duke deklaruar se shkresat e lëndës nuk përmbajnë autorizimin e tij për të përfaqësuar palët në procedurën gjyqësore.
44. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se avokati S.R., në bazë të dispozitës ligjore, ia ka bartur autorizimin avokatit E.G., i cili së bashku me kërkesën për revizion ia dorëzoi autorizimin Gjykatës Themelore, “por nga ana e administratës së Gjykatës Themelore me vetëdije ose pa vetëdije e njëjta nuk është dorëzuar së bashku me revizionin pranë Gjykatës Supreme”.

45. Rrjedhimisht, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me këtë rast janë shkelur të drejtat themelore të njeriut të paditësve (parashtruesve të kërkesës) kur, për shkak të autorizimit, i cili nuk ishte dorëzuar nga Administrata e Gjykatës Themelore, revizioni i tyre ishte refuzuar dhe nuk u morën parasysh dhe as nuk u lexua kërkesa e tyre mbi thelbin e çështjes e cila ishte relevante gjatë gjithë procedurës së gjykimit.
46. Parashtruesit e kërkesës konsiderojnë [...] “se nga Gjykata Supreme është dashur të bihet një aktvendim me të cilin e udhëzon palën paditëse (parashtruesit e kërkesës) apo e urdhëron të njëjtën që ndaj këtij revizioni të ushtruar ndaj vendimeve gjyqësore a është e vërtetë se avokati në fjalë a ka të drejtë përfaqësimi apo të drejtë të ushtroj mjetin e jashtëzakonshëm juridik, e çka Gjykata Supreme fare nuk është lëshuar të shikoj këto ose të bie këtë aktvendim të lartëcekur”.
47. Krahas kësaj, parashtruesit e kërkesës shtojnë se ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese edhe nga Kryeprokurori, i cili në njoftim ka konstatuar se e pranon vendimin e Gjykatës Supreme, dhe kështu ka refuzuar si të pabazuar propozimin e tyre për mbrojtjen e ligjshmërisë, ndërsa nuk e ka marrë parasysh ligjshmërinë e vendimit të kontestuar.
48. Parashtruesit e kërkesës i drejtohen Gjykatës me kërkesën në vijim; “qështjen kontestimore ta kthej në rishqyrtim dhe vendosje në gjykatën e shkallës së parë duke i anuluar të gjitha vendimet e tjera, në mënyrë që të vihet në pah e drejta e paditësve e cila u garantohet me Kushtetutë”.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 21

[Parimet e Përgjithshme]

1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.
2. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.
3. Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.
4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

Neni 24 **[Barazia para Ligjit]**

- 1. „Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
- 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
- 3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato “.*

Neni 54 **[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]**

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6 **(E drejta për një proces të rregullt)**

- 1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë”.*

LIGJI nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

KREU IV
PALËT DHE PËRFAQËSUESIT E TYRE

Neni 90

90.1 *“Vëllimin e autorizimeve të përfaqësuesit me prokurë e cakton vetë pala.*

Neni 93

[...]

93.2 *Gjykata mund të lejoj që veprimet në procedurë për palën përkohësisht t'i kryej personi që nuk e ka paraqitur prokurën, por njëkohësisht do ta urdhëroj atë që brenda afatit të caktuar ta paraqesë prokurën ose aprovimin e palës për veprimet procedurale të kryera.*

[...]

93.4 *Gjykata ka për detyrë që gjatë gjithë procedurës të kujdeset nëse personi që prezantohet si përfaqësues është i autorizuar për përfaqësim. Po që se gjykata konstaton se personi që prezantohet si përfaqësues nuk është i autorizuar nga pala për një gjë të tillë, do t'i anulojë veprimet procedurale të kryera nga personi i tillë, po që se veprimet e tija pala nuk i ka pranuar më vonë.”*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

49. Gjykata së pari vlerëson nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe të specifikuara në Rregullore të punës.

50. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

51. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individidi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]"

52. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cila konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin Rev. 54/2020 të Gjykatës Supreme të 6 korrikut 2020, pasi i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu i kanë qartësuar të drejtat dhe liritë që ata pretendojnë se u janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e kanë dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.
53. Gjykata gjithashtu përcakton nëse kërkesa e parashtruesve i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin 1 të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme në bazë të kushteve të përcaktuara në paragrafin (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
54. Në fund, Gjykata konsideron se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe, rrjedhimisht, duhet të shpallet e pranueshme dhe të shqyrtohen meritat e saj.

Meritat e kërkesës

55. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës kanë iniciuar procedurë kontestimore në Gjykatën Themelore në Prizren kundër Komunës së Prizrenit, në të cilën ata kërkuan të vërtetojnë se ata ishin bashkëpronarë të pronës së paluajtshme - parcelës kadastrale nr. 350 në sipërfaqe prej 0.69.40 ha, sipas fletës poseduese me nr. 90 ZK Petrovë në masë dhe kufij: në anën veriore në gjatësi 63,36 m, në anën jugore në gjatësi 70,03 m, në anën lindore në gjatësi 137,93 m dhe në anën perëndimore në gjatësi 116,88 m, dhe se e paditura komuna e Prizrenit merr përsipër që t'ua njohë këtë të drejtë të bashkëpronësisë atyre si paditës dhe t'ua dorëzojë në shfrytëzim të papenguar në të njëjtën kohë. Për këtë qëllim, ata me autorizime individuale autorizuan avokatët S.R., nga Prizreni, që në këtë procedurë kontestimore; **i)** t'i përfaqësojë ata, **ii)** të merr vendime gjyqësore, **iii)** të parashtrojë ankesa kundër vendimeve gjyqësore, **iv)** nëse është e nevojshme të ndërmerret të gjitha veprimet e nevojshme juridike në këtë çështje kontestuese deri në përfundimin

e saj me vendim të formës së prerë, dhe v) që mund t'i bartë autorizimet te një avokat tjetër.

56. Avokati S.R. si përfaqësues i autorizuar i parashtruesve të kërkesës, zhvilloi procedurë kontestimore pranë Gjykatës Komunale, të Qarkut dhe Gjykatës Supreme, duke vepruar ekskluzivisht në bazë të autorizimeve të tij të përfaqësimit. Megjithatë, më 4 qershor 2012, Gjykata Supreme nxori vendimin Rev. nr. 309/2009, me të cilin e aprovoi revizionin e të paditurës (Komuna e Prizrenit) dhe anuloi aktgjykimin Ac. nr. 541/2008 e Gjykatës së Qarkut të 18 shkurtit 2009, si dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore C. nr. 580/2003 të 14 majit 2008, dhe e ktheu lëndën në rigjykim.
57. Në procedurën e përsëritur në Gjykatën Themelore dhe të Apelit, avokati S.R. paraqitet përsëri si përfaqësues i parashtruesve të kërkesës. Mirëpo, pas nxjerrjes së Aktgjykimit C. nr. 681/12 të Gjykatës Themelore në Prizren të 10 prillit 2014 dhe Aktgjykimit Ac. nr. 2792/14, të Gjykatës së Apelit, të 18 tetorit 2019, avokati S.R., më 2 dhjetor 2019, transferoi autorizimin për përfaqësimin e parashtruesve të kërkesës te një avokat tjetër E.G., me qëllim të vazhdimit të procedurës kontestimore sipas e kërkesëpadisë së parashtruesve të kërkesës.
58. Më 9 dhjetor 2019, avokati E.G., duke u paraqitur si avokat i ri i parashtruesve të kërkesës, duke vepruar në bazë të bartjes së autorizimeve, parashtoi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, përmes Gjykatës Themelore, siç kërkohet me procedurë. Gjykata Supreme përmes aktvendimit e refuzoi kërkesën për revizion të avokatit E.G. si kërkesë të paautorizuar, duke theksuar se *“Revizionin kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë në emër të paditësve e ka paraqitur E. G., avokat nga Prizreni, ndërsa në shkresat e lëndës nuk ka autorizim me të cilin vërtetohet se paditësit e kanë autorizuar avokatin në fjalë për ta paraqitur revizionin në emër të tyre”*.
59. Sipas pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, pikërisht ky qëndrim dhe konkluzion i Gjykatës Supreme, shkel nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Më konkretisht, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se u janë shkelur të drejtat themelore të njeriut kur, për shkak të një autorizimi, i cili, sipas parashtruesve të kërkesës, nuk ishte dorëzuar nga administrata e Gjykatës Themelore, kërkesa e tyre për revizion ishte refuzuar për arsye thjesht formale, me ç'rast kërkesat e tyre të revizionit nuk ishin marrë parasysh. Për më tepër, ata konsiderojnë se edhe duke supozuar se autorizimi nuk ishte në shkresat e lëndës, Gjykata Supreme ka pasur obligim t'i pyesë, *„se avokati në fjalë a ka të drejtë përfaqësimi apo të drejtë të ushtroj mjetin e jashtëzakonshëm juridik”*.
60. Parashtruesit e kërkesës i kontestojnë konkluzionet e mësipërme në aktvendimin e Gjykatës Supreme lidhur me arsyet e refuzimit të revizionit, duke pretenduar shkelje të neneve 21, 23, 24, 31 dhe 54 të Kushtetutës. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës nuk i shpjeguan në mënyrë të veçantë pretendimet për shkelje të të drejtave të tyre. Megjithatë, bazuar në rrethanat faktike dhe ligjore të rastit, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesve të kërkesës në mënyrë indirekte tregojnë se pretendimet e parashtruesve të

paraqitura në kërkesë përmbajnë elemente të së drejtës për “qasje në gjykatë” si pjesë integrale e të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

61. Në procedurën e shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës brenda fushëveprimit të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata, duke iu referuar praktikës së saj gjyqësore dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, thekson se nuk është kushtëzuar nga karakterizimi i shkeljeve që pretendon parashtruesi i kërkesës. Në frymën e parimit *juria novit curia*, Gjykata është vetë përgjegjëse për karakterizimin e çështjeve kushtetuese që mund t’i përmbajë një rast i veçantë dhe mund të shqyrtojë vullnetarisht ankesat përkatëse, bazuar në dispozita ose qëndrime që nuk thirren shprehimisht nga palët (shih, në këtë drejtim, rasti Gjykatës: KI58/18, parashtrues: *Ahmet Frangu*, Aktgjykim i 22 korrikut 2020, paragrafi 81).
62. Përveç kësaj, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, ankesa karakterizohet nga faktet e përfshira në të, dhe jo vetëm nga baza ligjore dhe argumentet në të cilat palët thirren shprehimisht (shih rasti i GJEDNJ-së: *Talpis kundër Italisë*, aktgjykim i 18 shtatorit 2017, paragrafi 77 dhe referencat e cituara aty).
63. Prandaj, Gjykata do të vazhdojë t’i shqyrtojë pretendimet e parashtruesve të kërkesës nga pikëpamja e të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke aplikuar parimet e përcaktuara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në bazë të të cilave Gjykata në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e obliguar si në vijim: „*Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*”.
64. Në këtë drejtim, Gjykata së pari vëren se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës vazhdimisht konsideron se drejtësia e procedurës vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi (shih rastet e Gjykatës KI62/17, parashtruese: *Enine Simnica*, Aktgjykim i 29 majit 2018; paragrafi 41 dhe KI20/21 parashtruese: *Violeta Todorović*, aktgjykim i 13 prillit 2021, paragrafi 38; shih gjithashtu, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykim i 6 tetorit 1988, paragrafi 68). Prandaj, në procedurën e vlerësimit të bazueshmërisë së pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, Gjykata do t’u përmbahet këtyre parimeve.
65. Në lidhje me këtë dhe për të shqyrtuar pretendimet e parashtruesve të kërkesës, Gjykata do të shtjellojë parimet e përgjithshme në lidhje me të drejtën e “qasjes në gjykatë”, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në masën që lidhet me rrethanat e këtij rasti, për të vlerësuar aplikueshmërinë e këtyre neneve, në mënyrë që të vazhdojë me aplikimin e këtyre parimeve të përgjithshme në rrethanat e këtij rasti.

Parimet e përgjithshme në lidhje me të drejtën për “qasje në gjykatë” të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe praktika përkatëse ligjore

Parimet e përgjithshme

66. Përkitazi me të drejtën për “qasje në gjykatë”, e drejtë e garantuar me paragrafin 1 i nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht vëren se ajo tashmë ka praktikë gjyqësore të ndërtuar mbi parimet e vendosura nëpërmjet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së (përfshirë, por pa u kufizuar në rastin *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykim i 21 shkurtit 1975; *Bëleš dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, aktgjykim i 12 nëntorit 2002; *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, aktgjykim i 25 janarit 2000; dhe *Nait-Liman kundër Zvicrës*, aktgjykim i 15 marsit 2018). Megjithatë, rastet gjyqësore në të cilat Gjykata mbështeti parimet e vendosura nga GJEDNJ dhe i zbatoi ato në rastet përpara saj, duke përfshirë por pa u kufizuar vetëm në rastet KI62/17, me parashtrues *Emine Simnica* [aktgjykim i 29 majit 2018]; KI224/19, parashtrues *Islam Krasniqi* [Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020] dhe KI20/21 me parashtrues *Violeta Todorović* [Aktgjykim i 13 prillit 2021].
67. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përkatësisht rastit *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, ku theksohet se „e drejta e qasjes në gjykatë përbën një element që është i pandarë në të drejtën e përcaktuar në nenin 6 paragrafi. 1. Neni 6 para. 1 u siguron të gjithëve të drejtën për të iniciuar procedurë për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tyre civile pranë një gjykate ose tribunali. Në këtë mënyrë, ky nen përfshin “të drejtën për një gjykatë”, nga e cila e drejta e qasjes, përkatësisht e drejta për të filluar procedura pranë gjykatave në çështjet civile, përbën vetëm një aspekt të kësaj të drejte” (shih rastin e GJEDNJ *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 21 shkurtit 1975, cituar më lart, paragrafët 28-36).
68. Gjykata në këtë kontekst thekson se e “drejta në gjykatë”, si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, përcakton që palët në procedurë duhet të kenë një mjet efektiv juridik që ua mundëson mbrojtjen e të drejtave të tyre civile (shih e lartcekura KI224/19, parashtrues *Islam Krasniqi*, paragrafi 35; dhe KI20/21, me parashtruesen e lartcekur *Violeta Todorović*, paragrafi 41, shih në këtë kontekst dhe rastet e lartcekura të GJEDNJ-së, *Bëleš dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, paragrafi 49, dhe rastin e lartcekur *Nait-Liman kundër Zvicrës*, paragrafi 112).
69. Prandaj, në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe GJEDNJ-së, e drejta e qasjes në gjykatë nuk nënkupton vetëm të drejtën për të filluar procedurat pranë një gjykate, por, me qëllim që e drejta e qasjes në gjykatë të jetë efektive, individit duhet të ketë gjithashtu një mundësi të qartë dhe reale për të kontestuar vendimin që shkel të drejtat e tij/saj. Më konkretisht, e drejta e qasjes në gjykatë nuk shterohet vetëm në të drejtën për të filluar procedurën në gjykatë, por kuptimi i saj është shumë më i gjerë pasi që përfshin të drejtën për “zgjidhjen” e kontesstit nga gjykata kompetente (shih rastin e lartcekur

KI62/17 me parashtrues *Emine Simnica*, paragrafi 55, rasti i lartcekur KI 224/19, me parashtrues *Islam Krasniqi*, cituar më lart, paragrafi 39 dhe KI20/21, me parashtrues *Violeta Todorović*, cituar më lart, paragrafi 43).

70. Gjykata më tej thekson se e drejta për qasje në gjykatë nuk është absolute, por mund t'i nënshtrohet kufizimeve, pasi që nga vetë natyra e saj kërkon rregullim nga shteti, i cili gëzon një liri të caktuar vlerësimi në këtë drejtim (shih në lidhje me këtë rastin e lartcekur të Gjykatës KI 20/21, me parashtruese *Violeta Todorović*, paragrafi 44).
71. Megjithatë, çdo kufizim i të drejtës së qasjes në gjykatë nuk duhet të kufizojë ose zvogëlojë qasjen e një personi në atë mënyrë apo në një masë të tillë që të dëmtohet vetë thelbi i "së drejtës në gjykatë". Kufizimet e tilla nuk do të jenë të pajtueshme nëse ato nuk ndjekin një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një raport i arsyeshëm i proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që dëshirohet të arrihet (shih rastin e lartcekur të Gjykatës KI 20/21, me parashtruese *Violeta Todorović*, paragrafi 45, dhe rastet e GJEDNJ-së: *Sotiris dhe Nikos Koutras ATTEE kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 nëntorit 2000, paragrafi 15, dhe *Běleš dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 61).

Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së

72. Gjykata, bazuar në rrethanat e rastit konkret, i referohet edhe praktikës gjyqësore përkatëse të GJEDNJ-së, e cila i referohet të drejtës së qasjes në gjykatë, nga pikëpamja e garantimit të parimeve të sigurisë juridike dhe administrimit të drejtë të drejtësisë, si parime themelore të shtetit të së drejtës në një shoqëri demokratike.
73. Në praktikën e saj gjyqësore, GJEDNJ-ja specifikoi se rregullat që përcaktojnë hapat formalë që duhen ndërmarrë dhe afatet kohore që duhet të respektohen në paraqitjen e ankesës synojnë administrimin e duhur të drejtësisë dhe duhet të konsiderohen në përputhje me këtë, dhe në veçanti me parimet e sigurisë juridike (shih *Canete de Goni kundër Spanjës*, aktgjykim i 15 tetorit 2002, paragrafi 36). Në lidhje me këtë, GJEDNJ specifikoi se rregullat përkatëse ose zbatimi i tyre nuk duhet t'i pengojnë palët në procedurë të përdorin mjetin juridik në dispozicion (shih në këtë kontekst rastin e GJEDNJ-së *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, aktgjykim i 25 janarit 2000, paragrafi 36). GJEDNJ-ja theksoi më tej se çdo rast duhet të shqyrtohet në dritën e rrethanave dhe elementeve specifike të procedurës në atë rast (shih *Kurşun kundër Turqisë*, aktgjykim i 30 tetorit 2018, paragrafët 103-104). Në këtë drejtim, GJEDNJ-ja nënvizoi më tej se në zbatimin e rregullave procedurale, gjykatat duhet të shmangin edhe formalizmin e tepruar që do të përjashtonte një gjykim të drejtë dhe fleksibilitet të tepruar që do të zhvlerësonte kriteret procedurale të përcaktuara me ligj (shih *Hasan Tunç dhe të tjerët kundër Turqisë*, aktgjykim i 31 janarit 2017, paragrafët 32-33).
74. Në mënyrë koncize, GJEDNJ në rastin *Zubac kundër Kroacisë* theksoi se „respektimi i rregullave formale në procedurën civile [...] ka një vlerë dhe rëndësi të tillë, saqë ndalon arbitraritetin dhe siguron vendimmarrje efektive për kontestet dhe gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, si dhe siguron

siguri juridike dhe respekt për gjykatën". (shih rastin *Zubac kundër Kroacisë* [DHM], aktgjykim i 5 prillit 2018, paragrafi 96). Në këtë rast, GJEDNJ nënvizoi gjithashtu "*megjithatë, e drejta e qasjes në gjykatë konsiderohet se është shkelur kur rregullat pushojnë së qeni në shërbim të sigurisë juridike dhe administrimit të duhur të drejtësisë dhe si rrjedhojë krijojnë një pengesë që i ndalon palët në procedurë që të gjykohen nga gjykata kompetente në themel* (paragrafi 98 i aktgjykimit në rastin *Zubac kundër Kroacisë*). Në kontekstin e kësaj të fundit, GJEDNJ-ja vlerësoi se në rastet kur autoritetet publike dhanë informata të pasakta ose të paplota, gjykatat vendore duhet të marrin parasysh mjaftueshëm rrethanat specifike të rastit në mënyrë që të mos zbatojnë rregullat dhe t'i praktikojnë ato në mënyrë shumë të ashpër (shih, në këtë drejtim rasti i GJEDNJ-së *Clavien kundër Zvicrës*, aktgjykim i 12 shtatorit 2017, paragrafi 27 dhe *Gajtani kundër Zvicrës*, aktgjykimi i 9 shtatorit 2014, paragrafi 75).

75. GJEDNJ gjithashtu në aktgjykimin *Lesjak kundër Kroacisë* (2010), përsërit atë që përbën një qasje përfundimtare në gjykatë ose të drejtën e qasjes në gjykatë: "*35. Gjykata përsërit se neni 6 para. 1 i Konventës u siguron të gjithëve të drejtën për të parashtruar kërkesë në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij civile pranë një gjykate ose tribunali. E drejta e qasjes, përkatësisht e drejta për të filluar procedura pranë një gjykate në çështjet civile përbën një aspekt të kësaj "të drejte në gjykatë"* (shih, veçanërisht, *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, të 21 shkurtit 1975, §§ 28-36, Seria A nr. 18). Në mënyrë që e drejta e qasjes të jetë efektive, individit duhet të ketë një mundësi të qartë dhe praktike për të kontestuar një akt që i pengon të drejtat e tij ose të saj (...).(shih: Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Lesjak kundër Kroacisë*, kërkesa nr. 25904/06, i 18 shkurtit 2010).
76. Përveç kësaj, GJEDNJ, ka përcaktuar se e drejta e qasjes në gjykatë nuk nënkupton vetëm të drejtën për të filluar procedurat pranë një gjykate, por, me qëllim që e drejta e qasjes në gjykatë të jetë efektive, individit duhet të ketë gjithashtu një mundësi të qartë dhe reale për të kontestuar vendimin që shkel të drejtat e tij/saj. Me fjalë të tjera, e drejta e qasjes në gjykatë nuk shterohet vetëm në të drejtën për të filluar procedurën në gjykatë, por kuptimi i saj është shumë më i gjerë pasi që përfshin të drejtën për "zgjidhjen" e mosmarrëveshjes nga gjykata kompetente.
77. Gjykata më tej thekson se e drejta për qasje në gjykatë nuk është absolute, por mund t'i nënshtrohet kufizimeve, pasi që nga vetë natyra e saj kërkon rregullim nga shteti, i cili gëzon një liri të caktuar vlerësimi në këtë drejtim.
78. Në dritën e kësaj, Gjykata rikujton arsyetimin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut (Raporti i 5 prillit 1995, *Société Leuven Prestations Services kundër Francës*, nr. 21920/93, paragrafi 40): "[...] Komisioni konsideron se vendimi i [Gjykatës Supreme] i cili në këtë rast çoi në papranueshmërinë e ankesës për çështje të ligjit, kishte pasoja joproporcionale dhe të pabarabarta në të drejtën e parashtruesit për qasje në gjykatë dhe ia ka mohuar [atij] në praktikë mundësinë e ushtrimit të mjetit juridik që ishte efektiv në ligjin e [brendshëm]."

79. Me fjalë të tjera, çdo kufizim i të drejtës së qasjes në gjykatë nuk duhet të kufizojë ose zvogëlojë qasjen e një personi në atë mënyrë apo në një masë të tillë që të dëmtohet vetë thelbi i “së drejtës në gjykatë”. Kufizimet e tilla nuk do të jenë të pajtueshme nëse ato nuk ndjekin një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një raport i arsyeshëm i proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që dëshirohet të arrihet (shih rastet: *Sotiris dhe Nikos Koutras, ATTEE kundër Greqisë* (2000), paragrafi. 15, *Bëlesh dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* (2002), paragrafi 61).

Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese lidhur me të drejtën e qasjes në gjykatë

80. Gjykata, siç u përmend më lart, ka zbatuar parimet e mësipërme të përcaktuara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në praktikën e saj gjyqësore. Konkretisht, Gjykata, siç u theksua më lart, iu referua tri rasteve të Gjykatës, përkatësisht rastit KI 62/17, me parashtrues *Emine Simnica*, KI 224/19 me parashtrues *Islam Krasniqi* dhe KI 20/21 me parashtrues *Violeta Todorović*, në të cilat në disa raste Gjykata konstatoi shkelje të së drejtës për qasje në gjykatë, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
81. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet rastit të fundit të vendosur nga kjo Gjykatë, me ç'rast kjo e fundit, duke u thirrur dhe zbatuar parimet e mësipërme të përcaktuara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstatoi shkelje të së drejtës së qasjes në gjykatë, si një nga parimet e një gjykimi të drejtë në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës në rastin KI 20/21 kanë të bëjnë me faktin se më 21 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesë në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Privatizimit për të korrigjuar një gabim teknik të qartë të aktgjykimit të Kolegjit të Apelit, më 4 tetor 2019, duke deklaruar se aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar të 24 majit 2016 e ka pranuar më 15.06.2016, dhe kundër këtij aktgjykimi ka dorëzuar ankesën në Kolegjin e Apelit më 15 qershor 2016 brenda 21 ditëve. Më 1 tetor 2020, Kolegji i Apelit me aktvendim e refuzoi kërkesën e parashtruesit si të papranueshme, duke shtuar se aktgjykimi i Kolegjit të Apelit i 4 tetorit 2019 ishte i formës së prerë, megjithëse u konstatua se deklaratat e parashtruesit të kërkesës se aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar e kishte pranuar më 03 qershor 2016, ishte i saktë. Gjykata, duke marrë parasysh pretendimin e parashtrueses së kërkesës në lidhje me të drejtën e “qasjes në gjykatë”, konstatoi se Kolegji i Apelit, përkundër faktit se kishte konstatuar se pretendimet e parashtruesit ishin të vërteta, dhe se rrjedhimisht ankesa e saj ishte parashtruar në përputhje me afatet e parashtruesit të kërkesës. Ky i fundit, me aktgjykim të 4 tetorit 2019, ka refuzuar kërkesën e parashtruesit për korrigjim të gabimit të Kolegjit të Apelit, duke e konsideruar kërkesën e tij si kërkesë për rishikim të vendimit të gjykatës. Si rezultat, Gjykata Kushtetuese konstatoi se aktvendimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit pengoi parashtruesin e kërkesës që të shqyrtohet ankesa e tij kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar në merita, pavarësisht se ankesa e tij ishte paraqitur brenda afatit ligjor. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se Kolegji i Apelit ia kufizoi parashtruesit qasjen në gjykatë, gjë që çoi në shkelje të nenit 31.1 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së.

Zbatimi i parimeve të mësipërme në rrethanat e këtij rasti

82. Gjykata rikujton se procedura në këtë lëndë që u zhvillua pranë gjykatave të rregullta kishte të bënte me çështjen e ushtrimit të së drejtës pronësore mbi pronën e caktuar. Megjithatë, çështja e ngritur nga parashtruesit e kërkesës në këtë Gjykatë nuk kishte të bënte drejtpërdrejt me thelbin e kërkesëpadisë në lidhje me ushtrimin e këtyre të drejtave, por me çështjen e garancive procedurale të parashikuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, e cila lidh drejtësinë e procedurës gjyqësore dhe vetë thelbin e çështjes në tërësi.
83. Më konkretisht, Gjykata vëren se për parashtruesit e kërkesës, si palë në procedurat pranë gjykatave të rregullta, nuk është problematike procedurat gjyqësore që ata kanë zhvilluar në lidhje me pronën në fjalë në të cilën ata janë përfaqësuar nga avokati S.R., as me procedurën gjyqësore të zhvilluar në Gjykatën Themelore dhe të Apelit në procedurë të përsëritur, në të cilën gjithashtu si avokat paraqitet S.R.. Ajo që Gjykata konstaton se është fakt kontestues në bazë të së cilës parashtruesit e kërkesës i bazuan pretendimet e tyre për shkeljen e të drejtave të tyre para kësaj Gjykate është çështja që ka të bëjë me procedurën në Gjykatën Supreme, në lidhje me kërkesën për revizion, në të cilën përfaqësues i parashtruesve të kërkesës shfaqet një avokat i ri E.G., të cilit avokati S.R. ia ka bartur autorizimin për t'i përfaqësuar ata, në përputhje me autorizimet në të cilat ata i dhanë një mundësi të tillë procedurale avokatit S.R.. Parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se, *“nga ana e administratës së Gjykatës Themelore, me vetëdije nuk është dorëzuar në Gjykatën Supreme së bashku me revizionin edhe autorizimi i avokatit E.G. të cilin e ka dorëzuar në momentin e parashtrimit të revizionit në Gjykatën Themelore”*.
84. Megjithatë, në vlerësimin e bazueshmërisë së pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, Gjykata nuk do të merret me spekulimet lidhur me pretendimet se administrata e Gjykatës Themelore në Prizren qëllimisht e ka lënë jashtë shkresave të lëndës autorizimin, të cilin me rastin e parashtrimit të revizionit e ka dorëzuar avokati E.G. për t'i përfaqësuar ata. Në vlerësimin e bazueshmërisë së pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, Gjykata do t'i përmbahet ekskluzivisht fakteve që dalin nga shkresat e lëndës para saj.
85. Duke pasur parasysh shkresat e lëndës dhe pretendimet ankimore, Gjykata gjen se nuk është kontestuese për Gjykatën Kushtetuese dhe për Gjykatën Supreme, që avokati E.G. ka paraqitur kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme në emër të parashtruesve të kërkesës. Gjykata konstaton se në bazë të vendimit të kontestuar Rev. 54/2020 të Gjykatës Supreme të 6 korrikut 2020, ku thuhet *„Revizionin kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë në emër të paditësve e ka paraqitur E. G., avokat nga Prizreni”*. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se parashtrimi i revizionit si formë ankese, është rregulluar me nenin 211 (Revizioni) i LPK-së, i cili në pjesën përkatëse thekson:

Neni 211

„211.1 Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, palët mund të paraqesin revizion brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën u është dorëzuar aktgjykim”.

86. Gjykata vëren se fakti i thjeshtë që parashtruesit kishin një mundësi ligjore për të parashtruar kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme nuk shpie domosdoshmërisht në përmbytjen e kushteve të “së drejtës për qasje në gjykatë” që rrjedh nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Prandaj, i mbetet Gjykatës të përcaktojë nëse aktvendimi Rev. 54/2020 i Gjykatës Supreme i 6 korrikut 2020, përmes të cilit është refuzuar kërkesa për revizion, të cilën në emër të parashtruesve të kërkesës e ka paraqitur avokati E.G., në pajtim me dispozitat ligjore.
87. Prandaj, duke u fokusuar në pretendimin kryesor të parashtruesve të kërkesës në lidhje me procedurën për paraqitjen e kërkesës për revizion në Gjykatën Supreme, Gjykata konstaton se Gjykata Supreme ka nxjerrë aktvendim me të cilin refuzohet revizioni i dorëzuar nga avokati E.G. si përfaqësues i parashtruesve të kërkesës për arsye thjesht formale, me ç’rast edhe konkludoi se *“në shkresat e lëndës nuk ka autorizim me të cilin vërtetohet se paditësit e kanë autorizuar avokatin në fjalë për ta paraqitur revizionin në emër të tyre”*.
88. Gjykata konstaton se Gjykata Supreme e arsyetoi këtë vendim me qëndrimin se *„E. G, avokat nga Prizreni, në procedurën sipas revizionit identifikohet si përfaqësues i paditësve. Përfaqësuesi me prokurë duhet të ketë autorizimin e dhënë nga pala dhe të identifikohet në autorizim emri i palës, të cilën e përfaqëson, pëlqimi i saj, dhe vëllimi i prokurës ose të gjitha këto pala autorizim dhënëse duhet ti konfirmoj gojarisht në procesverbal në gjykatë. Në shkresat e lëndës nuk ka autorizim me të cilin vërtetohet se paditësit e kanë autorizuar avokatin në fjalë për ta paraqitur revizionin në emër të tyre”*.
89. Megjithatë, duke marrë parasysh dhe vlerësuar këtë konkluzion të Gjykatës Supreme, Gjykata konsideron se i njëjti është ligjërisht i paqëndrueshëm për këtë Gjykatë, për arsye se Gjykata Supreme ka konkluduar *“se avokati E.G. ka dorëzuar revizionin dhe se identifikohet si përfaqësues i parashtruesve të kërkesës, por se ai nuk ka autorizim për përfaqësim”*. Ajo që kjo Gjykatë e konsideron problematike është qëndrimi i Gjykatës Supreme, e cila së pari, **i)** konkludoi se ishte paraqitur kërkesa për revizion, **ii)** se ishte parashtruar nga avokati E.G., i cili paraqitet si përfaqësues i parashtruesve të kërkesës, **iii)** se ai nuk ka autorizim për t’i përfaqësuar ata dhe **iv)** ta refuzojë kërkesën për revizion si të pabazuar, duke konstatuar se ajo është paraqitur nga një palë që nuk ka autorizim. Gjykata në bazë të aktvendimit të kontestuar Rev. 54/2020 konstaton se Gjykata Supreme ka arritur në një konkluzion të tillë vetëm në bazë të dokumenteve të dorëzuara nga Gjykata Themelore gjatë shqyrtimit të kërkesës për revizion të dorëzuar nga avokati E.G., pa ndërmarrë asnjë veprim procedural për të konstatuar vërtetësinë e fakteve rreth përfaqësimit në bazë të të cilit ai më pas do të mund të nxirrte një përfundim të tillë.
90. Në të vërtetë, para se të nxirren konkluzione për disa fakte apo veprime të rëndësishme, është e nevojshme të ndërmerren të gjitha veprimet procedurale të parashikuara me dispozitat ligjore, në mënyrë që një përfundim të ketë bazë në ligj dhe si i tillë të jetë ligjërisht i qëndrueshëm.

91. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton dispozitën përkatëse të nenit 93.2 të LPK-së, e cila në pjesën përkatëse përcakton:

“Neni 93.

[...]

93.2 Gjykata mund të lejoj që veprimet në procedurë për palën përkohësisht t'i kryej personi që nuk e ka paraqitur prokurën, por njëkohësisht do ta urdhëroj atë që brenda afatit të caktuar ta paraqesë prokurën ose aprovimin e palës për veprimet procedurale të kryera”.

92. Gjykata konsideron se dispozita ligjore e lartpërmendur e nenit 93.2 të LPK-së, **a)** nuk është e paqartë ose dykuptimëshe, **b)** ofron udhëzime të mjaftueshme se cili është detyrimi i gjykatave të rregullta në rastet kur një person paraqitet si përfaqësues i pretenduar, dhe **c)** çfarë veprimesh procedurale duhet të ndërmerret gjykata për të vërtetuar të gjitha rrethanat rreth përfaqësuesit të pretenduar.
93. Në dritën e kësaj, Gjykata rithekson se, për të konkluduar diçka, është e nevojshme të ndërmerren paraprakisht të gjithë hapat proceduralë të parashikuar me ligj për të përcaktuar të gjitha rrethanat që do të çojnë në një përfundim. A është obligim i Gjykatës Supreme që të ndërmerr veprime të caktuara procedurale në këtë rast për të hequr dyshimet nëse personi E.G. është përfaqësuesi i vërtetë i parashtruesve të kërkesës apo jo, është diçka që rregullohet dhe parashikohet ligjërisht në dispozitën përkatëse të nenit 93.4 të LPK-së, e cila përcakton:

„Neni 93.4

93.4 Gjykata ka për detyrë që gjatë gjithë procedurës të kujdeset nëse personi që prezantohet si përfaqësues është i autorizuar për përfaqësim. Po që se gjykata konstaton se personi që prezantohet si përfaqësues nuk është i autorizuar nga pala për një gjë të tillë, do t'i anulojë veprimet procedurale të kryera nga personi i tillë, po që se veprimet e tija pala nuk i ka pranuar më vonë.”

94. Rrjedhimisht, është evidente se ka qenë detyrë e Gjykatës Supreme që para nxjerrjes së një aktvendimi përmes të cilit e hedh poshtë kërkesën për revizion, në pajtim me nenin 218.2 pika a) të LPK-së, ku theksohet: *„Revizioni është i palejueshëm nëse e ka paraqitur personi i cili nuk është i autorizuar për paraqitjen e revizionit”*, që të ndërmerret të gjitha veprimet e nevojshme procedurale që të përcaktojë, nëse personi që ka paraqitur revizion, është i autorizuar që ta bëjë këtë në emër të personave, në emrin e të cilëve e parashtron revizionin, ose nëse u jepet mundësia parashtruesve të kërkesës që të sqarojnë, nëse avokati i cili në revizion paraqitet si përfaqësues i tyre, është në të vërtetë i tillë.
95. Gjykata është e mendimit(konsideron) se Gjykata Supreme ka vepruar në kundërshtim me veprimet e parapara me dispozitat përkatëse ligjore të neneve 93.2 dhe 93.4 të LPK-së, duke nxjerrë aktvendimin Rev. 54/2020, me të cilin hodhi poshtë me procedurë të shkurtër kërkesën për revizion të avokatit E.G.,

pa i dhënë mundësi atij të sqarojë pretendimin se ai ishte përfaqësues i parashtruesve të kërkesës, për më tepër, me një vendim të tillë dhe me mosveprimin e saj, Gjykata Supreme u mohoi parashtruesve të kërkesës “qasjen në gjykatë” në kuptimin e deklarimit të legjitimitetit të avokatit E.G., për t’i përfaqësuar ata si përfaqësues në procedurën e revizionit në Gjykatën Supreme.

96. Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme ka të drejtë të vendosë lidhur me kërkesat për revizion, por vetëm kur parashtruesve të kërkesës u jepet mundësia që të sqarohen rreth çështjes së përfaqësimit të tyre nga avokati E.G., ose t’i jepet mundësia që avokati E.G. i cili paraqitet si përfaqësues i parashtruesve të kërkesës në emër të të cilëve ka paraqitur kërkesën, që brenda një periudhe të caktuar kohore të sjellë dëshminë e përfaqësimit të parashtruesve të kërkesës, që është në pajtim me nenet përkatëse 93.2 dhe 93.4 të LPK-së të cituar më lart.
97. Përveç kësaj, edhe nëse kemi të bëjmë me disa kufizime të qasjes në gjykatë, të cilat si të tilla janë të mundshme në rrethana të caktuara, Gjykata nuk konstaton se Gjykata Supreme në aktvendimin e saj ka dhënë ndonjë shpjegim në lidhje me arsyet se pse i ka kufizuar parashtruesit e kërkesës që të aplikohen nenet 93.2 dhe 93.4 të LPK-së, që drejtpërsëdrejti çoi në kufizime në të drejtën e tyre të qasjes në gjykatë në masën që i ka penguar ata të vazhdojnë procedurën e revizionit (shih rastin e cituar më lart të Gjykatës KI 20/21, parashtruese *Violeta Todorović*, paragrafi 45, dhe rastet e GJEDNJ-së: *Sotiris dhe Nikos Koutras ATTEE kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 nëntorit 2000, para. 15, dhe *Bëlesh dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 61).
98. Gjykata vlerëson se, në rrethanat e rastit aktual, konkluzioni ekzistues i Gjykatës Supreme në aktvendimin Rev. 54/2020, bie ndesh medispozitat ligjore të nenit 93.2 dhe 93.4 të LPK-së. Për më tepër, një konkluzion i tillë i Gjykatës Supreme është në kundërshtim edhe me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila thekson qartë se “*e drejta e qasjes në gjykatë nuk nënkupton vetëm të drejtën për të filluar procedurat pranë një gjykate, por, me qëllim që e drejta e qasjes në gjykatë të jetë efektive, individit duhet të ketë gjithashtu një mundësi të qartë dhe reale për të kontestuar vendimin që shkel të drejtat e tij/saj*. Me fjalë të tjera, e drejta e qasjes në gjykatë nuk shterohet vetëm në të drejtën për të filluar procedurën në gjykatë, por kuptimi i saj është shumë më i gjerë pasi që përfshin të drejtën për “zgjidhjen” e mosmarrëveshjes nga gjykata kompetente
99. Bazuar në sa më sipër, mund të vërehet se Gjykata Supreme ka nxjerrë aktvendimin Rev. nr. 54/2020, me të cilin e anuloi kërkesën për revizion me procedurë të shkurtër, pa i ndërmarrë të gjitha veprimet e parapara me ligj për të hequr dyshimin rreth legjitimitetit të personit, përkatësisht avokatit E.G., i cili paraqitet si përfaqësues i parashtruesve të kërkesës. Në këtë mënyrë, Gjykata Supreme ua kufizoi qasjen në gjykatë parashtruesve të kërkesës.
100. Prandaj, në bazë të të lartcekurave, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme, me nxjerrjen e aktvendimit Rev. 54/2020, i cili bazohet në nenin 218.2 pika a) të LPK-së, parashtruesve të kërkesës (i) u mohoi të drejtën për qasje në gjykatë

nga "pikëpamja e sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike, në kuptim të paragrafit 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së; dhe (ii) si rezultat, atyre iu pamundësua që të vazhdonin rastin e tyre në merita të padisë.

101. Gjykata konstaton se konkluzioni i Gjykatës Supreme përmes aktvendimit të lartpërmendur me të cilin refuzohet revizioni i E.G. si i pabazuar është nxjerrë me shkelje të së drejtës së parashtruesve të kërkesës për qasje në gjykatë. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se aktvendimi Rev. 54/2020 i Gjykatës Supreme i 6 korrikut 2020, nuk është në pajtim me paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës, lidhur me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.
102. Gjykata gjithashtu thekson se ky konkludim i referohet shkeljes së pretenduar kushtetuese. Kësisoj, Gjykata konfirmon se gjetjet që i përmban ky Aktgjykim nuk paragjykojnë në asnjë mënyrë rezultatin e procedurës në lidhje me rastin e parashtruesit të kërkesës.
103. Gjykata më tej rikujton se parashtruesit e kërkesës në kërkesën e tyre gjithashtu pretenduan shkelje të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], nenit 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës. Në këtë drejtim, siç u shtjellua më lart, rrethanat e rastit të parashtruesve të kërkesës përfshijnë elemente që lidhen me të drejtën e parashtruesve për qasje në gjykatë, si një nga parimet e garantuara me paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së dhe si rrjedhojë, pasi shqyrtoi pretendimet e tyre në dritën e kësaj të drejte, konstatoi se me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme është shkelur e drejta e tyre për qasje në gjykatë, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Prandaj, si rezultat i këtij përfundimi, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme të shqyrtojë në mënyrë të veçantë pretendimet për shkeljen e të drejtave të garantuara me nenet 21, 23, 24 dhe 54 të Kushtetutës.

Përfundim

104. Gjykata shqyrtoi pretendimet e parashtruesve të kërkesës dhe përkundër faktit se parashtruesit e kërkesës në kërkesën e tyre pretenduan edhe shkelje të neneve 21, 23, 24 dhe 54 të Kushtetutës, Gjykata konstatoi se rrethanat e këtij rasti përmbajnë elemente që kanë të bëjnë me shkeljet e pretenduara të së drejtës së tyre për qasje në gjykatë si një nga parimet e garantuara në paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së. Në vijim, për të vlerësuar dhe shqyrtuar këtë pretendim, Gjykata me qëllim të vlerësimit ka zbatuar praktikën gjyqësore të Gjykatës si dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.
105. Gjykata, pas shtjellimit dhe shqyrtimit të procedurës dhe arsytimit të aktvendimit të Gjykatës Supreme, konstatoi se: (i) paragrafi 1 i nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 të KEDNJ-së nga pikëpamja e parimit të së drejtës për qasje në gjykatë, është i zbatueshëm në rastin e parashtruesve të kërkesës; (ii) që konkluzionet dhe konstatimet e Gjykatës Supreme në lidhje me legjitimitetin e avokatit E.G. si përfaqësues i

parashtruesve të kërkesës, nuk është në proporcion me qëllimin e ndjekur për të garantuar sigurinë juridike dhe administrimin e duhur të drejtësisë, si një nga parimet bazë të sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike; (iii) se si rezultat i këtij interpretimi dhe gjetjeve të Gjykatës Supreme, në aktvendimin e saj të kontestuar, parashtruesve të kërkesës u është mohuar “e drejta për qasje në gjykatë” nga pikëpamja parimit të sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike, brenda kuptimit të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së; dhe (v) rrjedhimisht, atyre iu është pamundësuar të vazhdonin me rastin e tyre për të shqyrtuar meritat e kërkesës. Në fund, Gjykata konkludoi se aktvendimi i kontestuar Rev. 54/2020 i Gjykatës Supreme i 6 korrikut 2020, është nxjerrë në kundërshtim me të drejtën e parashtruesve të kërkesës për qasje në gjykatë, e cila garantohej me nenin 31, paragrafi 1 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së.

106. Në fund, Gjykata, si rezultat i konkluzionit të saj për shkeljen e të drejtës së parashtruesve të kërkesës për qasje në gjykatë, e garantuar me nenin 31 paragrafi 1 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së, nuk e konsideron të nevojshme që të shqyrtohen veçanërisht pretendimet për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 21, 23, 24 dhe 54 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, më 20 janar 2022, njëzëri,

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TË SHPALLË TË PAVLEFSHËM Aktvendimin e Gjykatës Supreme Rev. 54/2020 të 6 korrikut 2020;
- IV. TA KTHEJË rastin në Gjykatën Supreme për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;
- V. TA URDHËROJË Gjykatën Supreme që ta njoftojë Gjykatën deri më 1 korrik 2022, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra me qëllim të zbatimit të aktgjykimit të Gjykatës ;
- VI. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje, në pritje të zbatimit të këtij urdhri;
- VII. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- VIII. TA PUBLIKOJË këtë vendim ne Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IX. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka-Nimani